



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË**

Nr. 67/1 Prot.

Tiranë, më 20.01.2026

THIRRJE PËR BASHKËPUNËTORË

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM nr.98, datë 27.02.2019, të Kryeministrit, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP), nenit 7 dhe nenet 10-12 të Urdhrit të Ministrit nr.32, datë 28.01.2020, “Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, rregullores së brendshme nr. 492 datë 30.07.2020, “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm” në zbatim të planit të veprimtarive të ASCAP, shpall kërkesën për bashkëpunëtorë të jashtëm që mund të angazhohen në realizimin e veprimtarive të planifikuara dhe miratuara në planin e punës së institucionit.

A. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët e mësuesisë.
2. Të kenë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në arsimin parauniversitar.
3. Të ketë vlerësimin “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm” në kualifikimin përkatës.
4. Të kenë përvojë paraprake në një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:
 - Zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës në profilin dhe ciklin përkatës;
 - Zhvillimin profesional të mësuesve (përgatitje e materialeve për trajnimin e mësuesve, zhvillim i trajnimeve etj.);
 - Menaxhimin e veprimtarive apo projekteve në institucionin arsimor ku punon;
 - Drejtimin dhe menaxhimin e institucionit arsimor;
 - Mbështetjen e shërbimit psiko-social në institucionin arsimor;
 - Mbështetje të sigurisë së nxënësve në mjedisin arsimor;
 - Sigurimin e gjithëpërfshirjes në institucionin arsimor përmes punës me grupe me nevoja të veçanta;
 - Bashkëpunimin me ASCAP dhe institucione të tjera të varësisë së MAS për realizimin e veprimtarive të tyre në mbështetje të edukimit në arsimin parauniversitar;
 - Etj.
5. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.

6. Preferohen përfshirjet afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
7. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

B. Dokumentacioni dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrimi (CV-ja)
2. Fotokopje e diplomës së institucionit të arsimit të lartë
3. Certifikatë kualifikimi (nëse e disponon)
4. Fotokopje të kartës së identitetit ID.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet me postë pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me adresë: Rruga Naim Frashëri, Nr.37, Tiranë.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit deri me 29.01.2026

Faleminderit!